



Prishtinë, 15.08.2008
Kodi i ZRRE-së: D_113_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e N.Q Gjakova për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të N.Q Gjakova, të datës 21 prill 2008, **në seancën e mbajtur më 15 gusht 2008 nxori këtë:**

VENDIM

I. I lejohet “N.Q Gjakova” derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore;
- Licencës për Shpërndarjen e Ngrohjes Qendrore; dhe
- Licencës për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore, si në shtojcën e këtij vendimi.

1. Të gjitha dispozitat tjera të licencave të “N.Q Gjakova” mbesin në fuqi.
2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar



Nenet e deroguara të Licencave të N.Q Gjakova

Licenca e Gjenerimit N.Q GJAKOVA			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 "NQ Gjakova" duhet të dorëzoi Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007. NQ Gjakova ka dorëzuar draft raportin e auditimit financiar për vitin 2007, për shkak se ende nuk është finalizuar dhe nuk është aprovuar ky draft. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2	Neni 5- Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Rrjetit, Matjes dhe RRPKPF	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
3	Neni 8-Mjedisi	30.09.2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
4	Neni 11-Obligimi i Sigurimit	deri me 30 shtator 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset e Operatorit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 "NQ Gjakova" duhet të dorëzoi Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007. NQ Gjakova ka dorëzuar draft raportin e auditimit financiar për vitin 2007, për shkak se ende nuk është finalizuar dhe nuk është aprovuar ky draft. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2	Neni 5- Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Rrjetit, Matjes dhe RRPKPF	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
3	Neni 5-Detyrimet e të Licencuarit lidhur me pajisjet matëse	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
4	Neni 12.1-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit		Përmbushja e këtyre standardeve nga "NQ Gjakova" nuk varet ekskluzivisht nga eksperti i sigurisë së sistemit. Ky ekspert i aprovuar nga ZRRE është i obliguar të bëjë auditimin e sigurisë së sistemit. Ai mund të ndihmojë me ekspertizën e vet në përpilimin e këtyre standardeve, mirëpo ky është obligim i NQ Gjakovës. Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati për këtë nen gjer me 31.12.08
5	Neni 14-Qasja në Tokë dhe Ndërtesë	deri me 30 shtator 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
Licenca për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore			
Nr.	Neni	Kërkesa për Derogim	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 "NQ Gjakova" duhet të dorëzoi Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007. NQ Gjakova ka dorëzuar draft raportin e auditimit financiar për vitin 2007, për shkak se ende nuk është finalizuar dhe nuk është aprovuar ky draft. Për Llogaritë e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2	Neni 5- Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Rrjetit, Matjes dhe RRPKPF	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.